

VLERA DHE VLERËSIMET NË STUDIMET LETRARE SHQIPTARE THE VALUE AND THE EVALUATION IN ALBANIAN LITERATURE STUDIES

HAMIT XHAFERI

Fakulteti i Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit, Universiteti i Evropës Juglindore, Tetovë, MAQEDONI

Email: h.xhaferi@seeu.edu.mk

Përmbledhje

Në letërsinë tonë bashkëkohore problemi i vlerës duhet analizuar në pajtim me rregullat dhe kriteret më të përhapura që praktikohen në letërsinë evropiane dhe ate botërore. Vlerësimin s'mund ta lëmë jashtë kufijve të shkencës mbi letërsinë dhe artin, sidomos në rastin e verifikimit të problematikës specifike të hulumtimit, pasi nuk mund të krijojmë çfarëdo sinteze letraro-artistike. Kategoria elementare mbështetet në format e ndryshme gjuhësore (në organizimin, strukturën, njehsimin organik dhe bukurinë e sistemit). Shprehësia e imazhit (të cilin studiuesit shpesh e emërtojnë si "plastik" ose "gjallëri fytyrash"), nuk është as nocion i qartë, as vlerë njësoj e rëndësishme për tipet e ndryshme të tablove letrare. Këto vlera krijohen sipas faktit se disa fytyra ose situata të prezantuara në veprën letrare ngërthejnë veti të tilla (si komikja, tragjikja, hyjnorja), të afta për vetveten për të nxitur vlersime të ndjeshme, specifike. Kritika e vërtetë asnjëherë nuk dëshiron të vërtetojë, por vetëm të tregojë, sepse është akt kreativ i shpirtit të lirë.

Fjalët çelës: konkretizimi, personazhi, motivimi, konflikti, ideja, struktura gjuhësore.

Key words: The reflection, personage, motivacion, conflict, idea, language strukture.

Disa nga studiuesit e letërsisë shqiptare, sot, rëndomë, e kanë lënë anësh problemin e vlerës dhe të vlerësimit. Kjo lëkundje dhe ky moskujdes ndaj frymës së krijimtarisë letrare rrjedh nga shumë shkaqe. Këtu, pjesërisht, ndikon botëkuptimi i precizitetit shkencor, sidomos kur mënjanohet vlerësimi nga teksti struktural. Disa kritikë letrarë ose u frikësohen përgjithësisht në emër të veçantisë së veprës, e cila njihet, ose drejtpërsëdrejti kanë marrëdhënie miqësore me autorin dhe nuk duan t'ia prishim hatrin këtij. Andaj më shumë dëshirojnë të vlerësojnë tërthorazi ose me ndihmën e interpretimit, apo

përmes debatit letrar që është një lloj shumë i adhurar nga letrarët tanë, ose fare të mos e vlerësojnë, pasi merren me çështjen e pavendosmërisë. Megjithëkëtë, nuk duhen mohuar meritat dhe kontributet e konsiderueshme të atyre që kanë patur një qasje më pragmatike dhe të sinqert ndaj vlerës apo antivlerës së veprës letrare. Në të vërtetë, disa komentues e mohojnë fare ekzistimin e kësaj pavendosmërie, duke theksuar vështirësinë e detyrës që kanë si dhe nevojën praktike të vlerësuesit që të bëjë një vlerësim real, cilësor dhe kuptimplotë. Kështu që problemi i vlerësimit duhet të zgjidhet në rrafshin letrarë sipas kriterëve të përcaktuara mirë, duke u larguar nga ndërgjegja e papastër, që ka herë disa kritikëve, vlerësuesve dhe interpreuesve u ka munguar guximi, apo nuk kanë dashur të kuptojnë se bazat e vlerësimeve kanë qenë subjektive dhe jokonsekuente. Duhet të pranojmë se të menduarit mbi problemet e vlerësimit për disa nga studiuesit e letërsisë sonë, më shumë është kuptuar si pakufishmëri profesioni, pasi nuk kanë dashur të mendojnë thellë për përgjegjësinë që kanë ndaj artit dhe kulturës shqiptare. Koha e re, me prirjen e vet letrare dhe profesionale për të vërejtur dhe me dëshirën për eksperiment, i dha një impuls të fuqishëm shkencës së letërsisë dhe vetë vlerës letrare dhe vlerësimit nëpër gjithësi. Një gjë e tillë solli plejadën e kritikëve të rinj që dispononte me një dioptri tjetër leximi, analizimi dhe këndvështrimi gjithpërfshirës e modern.

Ndërkaq, po t'i qaseshim kësaj pune mjaft të ndjeshme të krijimtarisë letrare, në radhë të parë brenda përkufizimeve të një teze të tillë ose të çfarëdo analize tjetër të ngjashme letrare, lidhur me vlerësimin do të mund të nxirrim disa përfundime:

- së pari, duhet folur haptazi për këtë fenomen, pasi ende nuk kemi mundur të gjejmë një zgjidhje ndaj

vështirësive të kësaj natyre kaq të ndjeshme dhe me përgjegjësi;

- së dyti, duhet të largohemi nga paranoja e kritikëve letrarë të cilët pothuajse të gjithë pajtohen në vlerësimet e tyre duke thënë se “kjo është një vepër me veçori të jashtëzakonshme letrare”, ose “vepra është përplot me përshkrime të gjalla” dhe asgjë tjetër;

- së treti, ndeshim edhe të tillë, të cilët zhvillojnë polemika dhe dialogje të ashpëra, ose japin vërejtjet e tyre me patëkeq, apo përfundojnë me akuza serioze lidhur me një vepër të autorit;

- së katërti, kemi dhe kritikë letrarë të tillë të cilët përgjithësisht gjurmojnë vetëm ato libra që “bartin mesazhe të qarta, që janë me përmbajtje edukative, që flasin për heronj e personazhe me vlera etikomorale, që nxisin patriotizmin, dashurinë e krenarinë”. Edhe pse jemi të vetëdijshëm se nuk mundemi t'i eliminojmë tërësisht këto probleme, kemi bindjen gjithashtu se shkenca e letërsisë sonë, në zhvillimin e saj të mëtejshëm, do të jetë në gjendje t'i pakësojë këto, pasi kjo është e mundur. Kësisoj ky problem shqetësohet do t'i shërbente zhvillimit dhe disiplinimit tonë. Shkrimtari ynë i mirënjohur Fatos Kongoli lidhur me këtë problem do të thotë: "Tani kam frikë në do pëlqehet ajo që unë shkruaj apo jo. Ky është shqetësimi im. Të shkruaj diçka që të ketë vlerë". Problemet siç janë relativiteti i vlerës, krijojnë thelbin e përvojës thellësisht letrare. Një gjë të këtillë duhet ta kemi të qartë, kur e pyesim vetveten në cilën vepër tonën dhe me ç'rëndësi gjykimet apo vlerësimet tona mbi dukuritë letrare shqipe kanë karakter shkencor, letrar ose artistik? Përgjigjja do të ishte se vlerësimin s'mund ta hedhim jashtë kufijve të shkencës mbi letërsinë dhe artin, sidomos në rastin e verifikimit të problematikës specifike të hulumtimit, pasi nuk mund të krijojmë çfarëdo sintheze letraro-artistike. Në zgjidhjen e elementeve të rëndësishme të veprës letrare dhe funksionit të tyre, duhet të vendosin vlerësimet e drejtpërdrejta, që shpiejnë në vlerësime të ndjella nga rrethanat aktuale letrare. Ndonëse kësaj pyetjeje nuk është lehtë t'i përgjigjemi, mbase, arsyen e vërtetë do ta gjejmë tek ata që duhet t'a realizojnë këtë punë, pra në mesin e brezit të krijuesve bashkëkohorik dha paraardhësve të tyre. Gjithsesi këtë çështje mund ta zgjedhim duke u mbështetur në disa kriteret dhe parime që kanë efekte në kohë dhe hapësirë. Atëherë, sërish shtrohet pyetja tjetër se çfarë roli lot vlerësimi në kuptimin më të gjerë në rastin kur i qasemi letërsisë, duke u nisur nga qëndrimi që libri të botohet sipas recensionit dhe sugjerimit që atë ta blejnë bibliotekat dhe në fund të përfundojë në listën e lektrave shkollore, si vepra të domosdoshme për

lexim dhe studim. Përballë trashëgimisë letrare, gjithnjë e më shumë ne ndeshemi me rritjen e përhershme të produktivitetit letrar dhe qarkullimit të tij ndërkombëtar. Sot, në kohën kur roli i librit në konsumin e përgjithshëm të vlerave kulturore zvogëlohet, edhe problemi i zgjedhjes dhe i vlerësimit bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm. Shkenca mbi letërsinë sigurisht mund t'i botojë të plotë këto probleme, duke i lënë anësh qëndrimet arbitrare dhe të pabrenga të kritikës letrare në frontin e kulturës, të cilat, do të ishin të dëmshme për shoqërinë shqiptare. Problemi i vlerësimit duhet të analizohet në letërsinë tonë bashkëkohore në pajtim me rregullat dhe kriteret më të përhapura që praktikohen në letërsinë evropiane dhe atë botërore. Me termin vlerë duhet të nënkuptojmë aftësinë e shprehjes letrare dhe artistike të një veprë që plotëson funksionin për të kënaqur një nevojë të caktuar lexuesish të apasionuar pas artit. Vlera gjithmonë është vlerë, për këdo dhe në këtë kuptim ajo është subjektive, por në të njëjtën kohë ka edhe aspektin e saj objektiv, sepse varet prej vetive të lëndës së dhënë si tërësi ose prej shijeve letrare. Vlera, andaj në mënyrë potenciale ekziston në përmbajtjen e veprës, ndërsa shprehet dhe aktualizohet gjatë leximit të saj duke i plotësuar nevojat dhe kërkesat e lexuesit të mirëfilltë. Kjo vlerë e veprës mund të jetë cilësi e një lloji dhe e përbërë prej kualitetesh të ndryshme. Këto vlera ndikojnë në vetëdijen dhe ngritjen intelektuale të njeriut normal në mënyrë të sigurtë.

Vështirësia e mëtejme qëndron në faktin se vepra letrare e dhënë për vlerësim duhet të jetë vepër e pavarur nga përjetimi i atij që e merr në dorë, kurse kualiteti paraqitet pasi të konkretizohet. Këto konkretizime, veçanërisht në lëmin e sistemeve të larta të kuptimeve të tilla siç janë personazhi letrar, motivimi i veprimit, konflikti i ashtuquajturës kategori estetike, ideja e veprës, në veprën letrare si strukturë gjuhësore, të gjitha këto përcaktohen vetëm përafërsisht. Përgjithësisht, identiteti i lëndës për vlerësim, nuk është i garantuar. Sado që teorikisht mund të arsyetohet, dallimi i vlerave të veprave letrare si lëndë artistike prej vlerave të konkretizuara estetike, në praktikë, mund të vlerësohen vetëm përafërsisht. Vepra artistike ka arsyetimin e vet vetëm në saje të funksionit të qartë moralo-didaktik, pra mund të shërbejë si arsyetim, nëse jo edhe si shfaqësim. Ndërkaq, romani këtë arsyetim e sjell, por për fat të keq në dëm të vitalitetit dhe vlerësimit të veprës.

Është e vërtetë se nganjëherë, vlerësimet për veprat letrare jepen në bazë të observacioneve të vetive të tyre objektive, duke lënë anësh konkretizimin e tyre si lëndë estetike. Do të thotë jepen pa ndjenjë mendime dhe gjykime mbi kualitetin e tyre. Ky është gjykim mbi

vlerat potenciale të veprës letrare pa aktualitetin e saj të mëparshëm. Një vlerësim i tillë edhe pse shpeshherë i qëlluar, nuk është tjetër pos vlerësim hipotetik dhe bazohet në njohurinë se veprat tjera letrare, me të njëjtat veti objektive, posedojnë po ashtu vlerë estetike.

Vështirësi tjetër në definimin e nevojave dhe kërkesave, shkakton edhe funksioni i veprës letrare. Vlera e veprës letrare ka aftësi të kënaqë nevojat e të përjetuarit estetik. Por ato përjetime, sidomos ndaj veprave letrare, shumë vështirë mund të definohen. Megjithatë, është e vërtetë historike se vepra letrare në të kaluarën, pa dyshim, u ka shërbyer nevojave jashtestetike të konsumit, e pjesërisht edhe sot u shërben këtyre nevojave. Prandaj, gjithmonë e përsërisim pyetjen: cilat sfera të vlerës janë të ngjashme me veprat letrare, pyetje kjo së cilës duhet dhënë përgjigje. Jemi të vetëdijshëm se kualitetet konkrete, në të cilat ato kategori dallohen, shumë vështirë formohen në një vetëdije të tillë konceptuese. Përmes kualiteteve dhe kategorive të vlerës është vështirë të caktohet vetija objektive e veprës letrare. Këtë e shkakton, mes tjerash, jopreciziteti i aparaturës përshkruese, të cilën e zbatojmë kur i qasemi veprës letrare, madje kur një varshmëri e tillë, mund të zbatohet përpikërisht, kur si veti objektive del vlerësimi, kualiteti, ose vlera negative, nganjëherë del vetia e papërcaktuar e vlerës letrare. Mprehtësia e pamjaftueshme e kategorive të vlerësimit, mes tjerash, del në pah për secilën nga ato kategori si një paralelizëm negativ dhe neutral. Cili prej lexuesve do ta pranojë veprën letrare varet nga përjetimi subjektiv i lexuesit. Përjetimet të shumtën e rasteve pjesërisht përpjestohen në mënyrë të rëndomtë. Kështu, kur kemi arritur deri tek vetitë objektive të veprës letrare, mund të flasim vetëm për llojin e kualitetit që vlerësohet në atë substrat, në cilën shkallë kjo do të konsiderohet si vlerë, në këtë hapësirë observacioni. Këtë vlerë, në të vërtetë, lexuesi X do ta definojë si euritmike, kurse lexuesi Y si monotoni ritmike. Atëherë cili nga këta dy lexues ka të drejtë? Në këtë mënyrë na imponohet pyetja: a janë të gjitha vlerësimet njëjloj të rëndësishme? Intuita na shtyn të përgjigjemi negativisht, por pastaj do të gjendemi para vështirësisë së dokumentimit të kushteve, të cilat duhet t'i përmbushin vlerësimet kompetente, siç janë përvetësimi i gjuhës, njohja e përdorimit të konvencave letrare, përgatitja letrare, që do të thotë një masë e madhe përvojash analogjike, elementi i konkretizimit besnik të veprës letrare, kurse kriteret e vlerave nuk janë të përcaktuara, pastaj të kuptuarit e qëllimit artistik: (sepse qëllimi gjer në minimum është hipotezë), ndjeshmëria në lëmin e dhënë të letërsisë,

(andaj kallëzuesi kryesor i kësaj ndjeshmërie, në të vërtetë, është saktësia e vlerësimit letrar.

Veprat novatore letrare, gjatë perceptimit të tyre, shtrijnë ndjeshmërinë e konsumit, krijojnë në të nevoja të reja, thuajse, vetëm në këtë mënyrë krijojnë vlerat e tyre për lexuesit. Lënda e shkencës e krijon publikun, i cili e kupton artin dhe është në gjendje të përjetojë bukuritë. *Nga ky interpretim kërkohet që gjithësi të pranohet teoria sipas së cilës kreacioni letrar është vetvetiu një proces pjesërisht i nënvetëdijshëm.*

Nga këtu rrjedh edhe domosdoshmëria e korigjimit dhe e pasurimit të kriterëve ekzistuese të vlerësimit në bazë të përvojave të drejtpërdrejta të vlersimeve të veprës letrare. Kjo do të thotë se mundësia e kufizuar e të gjitha normave letrare, nuk mund të përfytyrojë kualitete të reja vlerash. Këto janë vështirësitë kryesore, të cilat paraqiten me rastin e shqyrtimeve në të gjitha sferat e vlerave të pranishme në letërsi. Cilat janë ato sfera vlerash të veprës letrare, që si të tilla, duhet të jenë lëndë studimesh letrare? Disa janë të prirur që këtë problem ta formulojnë ndryshe: ata duke pyetur se çfarë janë sferat e vlerave të veprës letrare, mohojnë vlerat tjera, sepse këtyre vlerave u mohojnë vendin në studimet letrare. Megjithkëtë, këto qëndrime mund t'i pranojmë si një bazë për shqyrtime të mëtejme. Teoria, e cila predikon idealet e kërkesave mbi vlerat origjinale letrare, në esencë, përcaktohet për vlerat e pranishme në të gjitha lëmitë e arteve. Nga gjithë kjo që u theksua, konstatojmë se konstruksionet e tilla posedojnë njohuri vlerash letrare dhe artistike që duhen verifikuar gjatë leximit të veprës letrare. Shumica e hulumtuesve, të cilët vlerat konstruksionale i konsiderojnë si sferë të parë ose më të rëndësishme të vlerave letrare, janë të vetëdijshëm për këto vështirësi që përfolën më lart. Andaj, disa prej tyre kapitullojnë para këtyre vështirësive, duke u arsyetuar me tezën mbi karakterin intuitiv të verifikimit letrar. Teorikët, të cilët u nënshtrohen këtyre kufijve, më së shpeshti i identifikojnë vlerat personale letrare me sferën e vlerës konstruktive. Ata gjenden në një pozitë të lakmuar, duke i sulmuar të tjerët, eliminojnë mundësinë të jenë vetë të sulmuar, pasi që në rëndësinë estetike të kësaj sfere nuk dyshon aksush. Kategoria elementare këtu mbështetet në format e ndryshme gjuhësore, siç janë: organizimi, struktura, njëhësimi organik, të bukurit e sistemit dhe ideali i vjetër “njësimi i shumëllojshmërisë”, ose më sakt njësimi maksimal i veprës letrare me shumëllojshmërinë e saj maksimale. Krijuesit e shumëllojshmërisë janë: shuma e elementeve të përbëra, gradacioni i tyre, llojllojshmëria, kundërtëhënia semantike dhe formale, sidomos tezat e estetikës bashkëkohore anglo-amerikane, shuma e rrafshëve

semantike si shfaqje e pavarur e tërësisë së veprës. Duke i analizuar për së afërmi të gjitha kategoritë e vlerave, mund të vërehen se disa prej tyre, në asnjë nuancë nuk kanë ngjashmëri veprash artistike. Mirëpo, me rastin e përvetësimit të këtyre kategorive, në interpretimet letrare vërehen tendencat e përgjithshme që shpiejnë kah absolutizimi i normave, madje edhe në poetikat e ndryshme historike. Shkakton dyshim edhe guri katror i analizës strukturale, koncepti i përshtatshmërisë funksionale i çdo elementi të vjetër letrar. Kur i kemi parasysh marrëdhëniet e autorit me kritikun letrar dhe qëllimin e tij në krijimin e veprës letrare, shpeshherë ndodh që funksioni i elementit të dhënë në veprën e tij, të arrij gjithmonë një cak të pabesueshëm.

Kritika është akt kreativ i shpirtit të lirë. Më vonë sigurisht intuïta mund të motivohet. Ky motivim është i bindshëm vetëm për atë, i cili përjeton. Akti themelor i kritikës është kontakti iracional. Kritika e vërtetë asnjëherë nuk dëshiron të vërtetojë, por vetëm të tregojë. Asnjë tërësi e caktuar konkrete s'mund të përshkruhet në mënyrë analitike. Mund të zbulohet vetëm me ndihmën e pasqyrës intuïtive të tërësisë në përgjithësimin e drejtpërsëdrejtë. Konkludimet e tilla janë të ngjashme me ato që pretendojnë ta fshijnë të vlerësuarit si pjesë përbërëse mbi letërsinë. A mund t'u kundërshtohet atyre me propozime optimiste? Në situatën e tanishme, sigurisht të vetme si postulat, veçimi i kategorive të vlerave, të cilat në një lëmë do të mbesin fatalisht të padokumentuara, do të ishte mirë që së paku, të mbesin të kuptueshme në një mënyrë konceptuale. Nga ana tjetër, përsëri do të mbesin si postuale të përshkruara në mënyrë precize, në aparaturën e veprës letrare. Edhe më shumë pikëpyetje nxit sfera e vlerave pikturale. Nëse jo për ndonjë shkak tjetër, atëherë për shkak se vetë nocioni "piktural" ose "pasqyruës" ndeshet mjaft në letërsi. Kurse në marrëdhënie me përjetimet e brendshme të prezentuara nëpër veprat letrare, ky nocion gjithnjë mbetet një masë i paqartë. Kjo veti shndërrohet në vlerë vetëm atëherë kur imazhet e imagjinatës së huajtur prej veprës letrare bëhen më të shpeshta, të qarta dhe në mënyrë kualitative të pasura. Vështirësia elementare rrjedh edhe nga fakti se në marrëdhënie me nxitjen gjuhësore, në një masë të konsideruar bëhen autonome dhe në këtë mënyrë, veçmas, shumë lehtë vihet gjer tek "përjetimet e tepruara". Andaj, të vlerësuarit, i nënshtrohet subjektivitetit të madh. Nga ana tjetër, shprehshmëria e imazhit (të cilin shpesh e emërtojnë "plastik" ose "gjallëri fytyrash"), as nuk është nocion i qartë, as nuk është vlerë njësoj e rëndësishme për tipet e ndryshme të tablove letrare. Duhet ta përkujtojmë edhe njëherë se i ashtuquajtur

"pikturim poetik", përkundër gjasës që të përfytyrohet pamundësisht ose në përpjektjet për të përfytyruar, shndërrohet në shëmti estetike ose në pakuptimshmëri ideore. Në polemikat rreth imazhitetit në letërsinë tonë këto dy variante shpesh nuk janë dalluar.

Karakterit piktoresk i veprës letrare paraqet një bazë, në të cilën rriten vlerat emotive të veprës letrare. Këto vlera krijohen sipas faktit se disa fytyra ose disa situata të prezantuara në veprën letrare posedojnë veti të tilla (si komikja, tragjikja, hyjnorja dhe të ngjashme), të afta që për vetveten të nxisin vlerësime të ndjeshme, specifike. Shembuj të tillë të mprehtësisë së kritikës komike ndeshim në publicistikën letrare të N. Bulkës dhe të novelave filozofike të Migjenit ("Tragjedi apo komedi", "Të korrurat", "Vetëvrasja e trumcakut", "Ose...ose", "Programi i një reviste", "Bukuria që vret" etj.) (Uçi, 1986: 483). Këto vlera, në mënyrë tradicionale bëjnë pjesë në kategoritë estetike. Gjersa trajtat e interpretimit të komikes në art dhe në grotesk, janë përdorur në mënyra dhe për qëllime të ndryshme, janë vlera vetëm estetikiisht kualitative, parimi i ndarjes së tyre nuk mund të jetë i qartë. Në letërsinë tonë vërejmë ca shembuj pozitiv të përdorimit të këtyre formave, siç bie fjala tek poema satirike e D. Agollit "Pleshti" ose figuracioni grotesk në poezitë "Ali Pashë Tepelena", "Koha e popujve", "Marshimi i akullnajës" dhe në romanet "Gjenerali i ushtrisë së vdekur", "Ura me tri harqe", "Pallati i ëndrrave" të I. Kadaresë (Uçi A., 1986: 487-488).

Në mesin e studuesve të letërsisë që janë marrë me problematikën e vlerës dhe vlerësimit të krijimtarisë letrare, sot ndeshim dhe të tillë që nuk i kanë kushtuar sa duhet vëmendje të duhur. Tek disa pjesërisht ka munguar botëkuptimi i saktësisë shkencore, të tjerët e kanë mënjanuar vlerësimin e tekstit struktural, ose në mungesë të guximit kanë zgjedhur anën e përgjithësimeve në emër të veçantisë së veprës dhe autorit. Andaj, në disa raste vlerësimi është bërë tërthorazi ose me ndihmën e interpretimit, apo fare nuk është vlerësuar vepra letrare. Nga frika nuk kanë bërë vlerësim real, ose nuk kanë dashur të kuptojnë se bazat e vlerësimeve të tyre janë subjektive dhe jokonsekuente. Fatos Kongoli rrëfen se ka ndërje të njëjtën kënaqësi në të gjitha vlerësimet, ashtu siç rrëfen që edhe i ka ardhur keq kur nuk është vlerësuar. Shquhen sidomos romanet e tij, të vlerësuar nga lexuesi shqiptar dhe i huaj. Megjithatë, kurrë nuk ka pasur hatërmbetje nga ana e tij. Sepse pak rëndësi ka nëse vlerësohet me çmim ose jo nga kritika. Vlerësimin më të përzemërt e merr nga lexuesit, për të cilët përkushtohet plotësisht dhe merr shijen më të mirë të

fitores. Shqetësimi im thotë ai është që të shkruaj diçka që ka ndonjë vlerë.

Për këtë arsye, duhet folur haptazi dhe guximshëm mbi këtë fenomen, pasi ende nuk kemi mundur të gjejmë një zgjidhje të vështirësive të kësaj natyre të ndjeshme, për tu larguar nga paranojat, edhe pse jemi të vetëdijshëm se nuk mundemi t'i eliminojmë tërësisht. Shkenca e letërsisë sonë, në zhvillimin e saj të mëtejshëm, është në gjendje së paku t'i pakësojë anomalitë e kësaj, sepse kjo është e mundur. Vlerësimin s'mund ta hedhim jashta kufijve të letërsisë dhe artit, pasi nuk mund të krijojmë çfarëdo sinteze letrare-artistike. Në kohën tonë gjithnjë e më shumë ndeshemi me rritjen e përhershme të produktivitetit letrar. Sot, kur roli i librit në konsumin e përgjithshëm të vlerave kulturore ka peshën e vet, edhe problemi i zgjedhjes së vlerave dhe vlerësimit duhen bërë sipas ligshmërive specifike të ndërtimit të veprës letrare. Duhet lënë anësh qëndrimet arbitrare dhe të pabrenga të kritikës letrare në fronin e kulturës letrare shqiptare. Në letërsinë tonë bashkëkohore duhet analizuar problemin e vlerës në pajtim me rregullat dhe kriteret më të avancuara që praktikohen në disa letërsi të popujve të Evropës. Ato, po ashtu janë vepra të rëndësishme në historinë e kritikës artistike dhe të krijimtarisë letrare. Janë të rëndësishme veçmas për atë degë të kritikës që merret me raportin dhe me vlerat e artit ndaj ndjenjave, nga njëra anë, dhe ndaj mendimit dhe kujdesit moral për lexuesit, nga ana tjetër. Kjo është periudhë e gjurmimit pas vlerave të reja letrare-artistike dhe individuale që do të mbështeteshin në pranimin e botës së re. Kërkimi i këtyre vlerave filloi kah fundi i shek. XIX, kurse u vazhdua në shek. XX e deri në ditët tona. U zhvillua edhe veprimtaria botuese në kuptimin modern të kësaj fjale. Por, analiza është një gjë, kurse ilaçi një gjë tjetër.

Në skenën e gjykimit dhe vlerësimit dhe në shumë poezi të pakuptimta, në të cilat kritika bashkëkohëse ka zbuluar një thesar vlerash të pasura anticipimesh të veprimeve moderne poetike. Këto veç e veç shfaqen në kontinuitetin e vlerave letrare, kurse në mënyrë implicite e madje edhe të hapur, në kundërtënie me to. Kjo kundërtënie në ide dhe ky theksim i krizës së trajtave të vendosura bëhet fal disa veçorive të reja stilistike, të cilat shek. XX do t'i shndërroj në konvenca fillestare për kërkimet dhe krijimet vetiake. Jo frytet e përvojës, por vetë përvoja është qëllim...si të ndodhemi në vatrën në të cilën numri më i madh i forcave jetësore bashkohen në energjinë e tyre më të pastër? Të digjesh gjithmonë si thesar, në këtë flakë të ashpër, do të thotë ta mbash ekstazën, këtu qëndron sukcesi i jetës së krijimtarisë letrare...Të mos zbulosh

në çdo moment ndonjë qëndrim të pasionuar tek ata përreth nesh, kurse në shkëlqimin e talentit të tyre ndonjë shmangie që të shpie drejt antivlerës, domethënë, në një drejtim të shkurtër përplot ngricë e errësirë, të fleshë para mbrëmjes në gjumin e pafund. Pasionet e mëdha mund të na ofrojnë përshtypjen për një jetë të shpejtësuar kreative të krijimtarisë letrare. Pasionet poetik, gjakimi ndaj së bukurës, dashuria ndaj artit për art kanë në vete më së shumti nga kjo urti, sepse arti na tregon sheshazi vlerat e vërteta. Lidhur me këtë Oskar Uajld do të thotë: Gjenialitetin tim e kam derdhur në jetë, kurse vetëm talentin në veprat e mia.

Mjafton që të zbulohet cilësia e eseve moderne që në vete ngërthejnë ndonjë problem aktual me përmbajtje shoqërore ose artistike, janë kryesisht komente të ngjarjeve aktuale në jetën kulturore dhe shoqërore shqiptare. Kritikët nuk do të pajtoheshin këtu assesi, sepse vlera e romanit nuk qëndron vetëm në llojshmërinë e fytyrave të paraqitura, as në shumësinë e skenave, por në strukturën e veprës, shkurt, në mënyrën në të cilën është paraqitur jeta në roman. Kritika sot mendon se autoriteti i krijuesve dhe kritikëve letrarë, nuk ka qenë gjithnjë aq i lartë, edhe pse e kemi të qartë se disa nga krijuesit tanë të shquar, gjithsesi hyjnë në mesin e shkrimtarëve më të mirë shqiptarë. Vlerësimi i lartë i veprës së tyre është përforcuar vetëm në shekullin tonë, kur romani filloi të konsiderohet si vepër serioze artistike, e jo vetëm si argëtim ose humbje kohe. Vetëm shkrimtarët si Kadare, Kongoli, A. Pashku, etj., kritikët modern filluan t'i konsiderojnë si paraardhës dhe model për gjeneratat e reja. Këta krijues në të vërtetë, me organizimin e shkëlqyeshëm të lëndës krijuese të tyre, me ekonomikitetin absolut që nuk lejon kurrfarë gjërash të tepërta, kanë krijuar atë që disa kritikë e quajnë "roman i pastër", domethënë, roman në të cilin trajta nuk është lënë pas dore në të mirë të rrëfimit amorf, por janë kultivuar deri tek normat e larta të përsosmërisë. Kjo assesi nuk do të thotë se bie fjala Fatos Kongoli është një formalist i thjeshtë dhe se harmoninë estetike e sendërton në dëm të përmbajtjes së veprës. Veprat e tij dalin nga realiteti shoqëror i Shqipërisë së kohës së tij. Në qendër të romaneve të tij ndodhen gjithnjë dilemat morale: si të mbahet integriteti moral dhe ndjenjor në konflikt me forcat e vrazhda të autoritetit të rrejtshëm komunist. Në përgjithësi, kritika bashkëkohëse me kënaqësi thekson se disa nga shkrimtarët tanë në thelb nuk kanë ndryshuar, por vetëm kanë evoluuar, kurse imazhi dualist i botës është pa dyshim ajo konstantë që e lidh artin e tij poetik në një tërësi të pandashme. Kjo shihet më së miri në poezitë e F. Arapit, Xh. Spahiu, A.

Podrimjes etj., domethënë në ato poezi në të cilat shprehin qëndrime kundërshtuese ndaj gjendjes aktuale. Këto poezi vetëm në perspektivën historike arritën të vlerësohen drejt nga kritika. Në revistat tona letrare paraqitet një kritikë e gjallë letrare e shoqërore të cilën e shkruanin mendjet më të shquara të kësaj periudhe. Edhe pse çdo revistë kishte orientimin e vet politik, të gjitha ato ofronin kritikën më të mirë letrare praktike të kësaj kohe.

Bibliografia

- PLASARI, Aurel (1993), *Letërsia dhe muret*, Tiranë.
PORADECI, Lazgush (1990), *Vepra letrare*, Tiranë.
QOSJA, Rexhep (1972), *Kontinuitete*, Prishtinë.
RUGOVA, Ibrahim (1986), *Kahe dhe premisa të kritikës letrare shqiptare 1504-1983*, Prishtinë.
SHEMA, Isak (1995), *Vrojtime letrare dhe artistike*, "Rilindja", Prishtinë.
UÇI, Alfred (1986), *Estetika*, Vëllimi I, Tiranë.